



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 18.11.2013, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Blerta Deliu – Kodra, Vjosa Osmani, Ismet Beqiri, Blerim Shala, Suzan Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Fatmir Limaj dhe Glauk Konjufca.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për investimet e huaja, me amendamentet e Komisioni Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisioni Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Vjosa Osmani – tha meqë e kemi nw rend tw ditës shqyrtimin e Planit të Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit propozoi që ky plan për shkak të rëndësisë që ka të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit pasi që duhet të kemi më shumë kohë për ta shqyrtuar atë. Po ashtu, meqë i njëjti dokument do të shqyrtohet edhe në seancë, duhet që analiza e komisionit të jetë më e thuktë dhe më e detaizuar.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, të shqyrtohet në mbledhjen tjetër të Komisionit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për investimet e huaja, me amendamentet e Komisioni Funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, e ftoi deputetin Albert Kinolli, referues të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Albert Kinolli, tha Projektligji për Investimet e Huaja rregullon mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë duke ju ofruar investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore dhe të ekzekutueshme që u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të drejtë në pajtim të plotë me sundimin e ligjit, standardeve dhe praktikave të pranuara ndërkombëtare.

Andaj, pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për investimet e huaja me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

4.Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës me amendamentet e Komisioni Funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, e ftoi deputeten Suzan Novoberdali, referuese të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzan Novoberdali, tha Projektligji për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Andaj, pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Kryetari i Komisionit

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Lutfi HAZIRI